Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0599

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 pas shqyrtimit të ankesës së OE Expert Company SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe instalimeve elektrike ne Kliniken e Kirurgjisë Pediatrike" me numër të prokurimit 701-23-3093-2-2-1, iniciuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) në cilësinë e Autoriteti Kontraktues (AK), Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj-Mexhuani me 25/09/2023, mori këtë:

Vendim

1.Hedhet si e palejuar ankesa e OE Expert Company SH.P.K., me Nr. të Protokollit 2023/0599 e datës 21/08/2023, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "*Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe instalimeve elektrike ne Kliniken e Kirurgjisë Pediatrike*" me numër të prokurimit 701-23-3093-2-2-1, iniciuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës "QKUK" në cilësinë e Autoriteti kontraktues (AK).

2.Fillohet procedura për marrje të masës disiplinore ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit në "QKUK" për shkak shkeljeve të evidentuara si më poshtë në arsyetimin e këtij vendimi.

3.Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Ankuesi obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale:

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 21.08.2023 ka pranuar ankesën me Nr. të Protokollit 599/23 nga OE Expert Company SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe instalimeve elektrike ne Kliniken e Kirurgjisë Pediatrike" iniciuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Me 03.04.2023,Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e lartcekur. AK me datën 25.05.2023 ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës.

Me tutje, aktiviteti i prokurimit i lartcekur si më sipër është kthyer në rivlerësim pasi që një operator tjetër ekonomik ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim dhe e njëjta i është aprovuar nga AK.

Pas rivlerësimit, AK me datën 19.06.2023 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit kaanuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se nuk ka pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme.

Kundër njoftimit për anulim OE "Expert Company" SH.P.K dhe "Ego Elsa" SH.P.K me datën 22.06.2023 dhe 23.06.2023 kanë parashtruar kërkesa për rishqyrtim. AK me datën 23.06.2023 në e-prokurim ka publikuar vendimin për refuzimin e kërkesave për rishqyrtim si të pabazuara.

Pra Autoriteti Kontraktues në E-Prokurim publikon dy vendime dhe atë:

Me 23.06.2023 refuzon Kërkesat për Rishqyrtim të OE Expert Company SH.P.K dhe "Ego Elsa" SH.P.K dhe me 10.08.2023 e refuzon Kërkesën për Rishqyrtim të OE Expert Company SH.P.K.

Kundër vendimit të cituar si më sipër (të datës 10.08.2023) OE Expert Company SH.P.K., i është drejtuar Organit shqyrtues të Prokurimit me Ankesën Nr. Protokolli 0599/2023 e datës 21.08.2023.

-*Vlerësimi dhe administrimi i provave*-

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe instalimeve elektrike ne Kliniken e Kirurgjisë Pediatrike" iniciuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës,

OE ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim me datën 22.06.2023, kurse AK ka publikuar lidhur me të njëjtën dy vendime dhe atë:

1. Vendimi i AK për refuzimin e Kërkesave për rishqyrtim i datën 23.06.2023
2. Vendimi i AK për refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim i datën 10.08.2023

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas analizimit të shkresave të lëndës konstaton se Ankesa e parashtruar në OSHP është jashtë afatit ligjor dhe nuk është parashtruar në pajtim me nenin 63 par 2 të Udhëzuesit 001/2022 cituar: "*Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe*

do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejtë që të parashtroj një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0)".

Po ashtu, sipas interpretimit të KRPP-së, 22.11.2022 lidhur me nenin 108/A të LPP-së, thuhet se: "*...Në rast se AK nuk ka lëshuar një vendim dhe/ose nuk e ka njoftuar ankuesin për zgjatje të afatit të rishqyrtimit (Paragrafi 6 i nenit 108/A të LPP-së) afati fillon të rrjedhë në ditën e tretë (3) (të fundit për kthimin e përgjigjes) pas pranimit të kërkesës nga OE e cila do të llogaritet dita "zero" e afatit për dorëzimin e ankesës në OSHP".*

Mbi bazën e të lartcekurave konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 21.08.2023 nga OE Expert Company SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit me titull "Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe instalimeve elektrike ne Kliniken e Kirurgjisë Pediatrike" iniciuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar ankesën brenda afateve ligjore, më saktësisht nuk ka dorëzuar ankesë në OSHP, sipas vendimit të datës 23.06.2023, mirëpo i është drejtuar OSHP me vendimin e dytë të AK i cili përmban datën 10.08.2023 (vendim i përseritur i AK pa zhvilluar asnjë procedurë vlerësimi, i cili refuzim i kërkesës për rishqyrtim i referohet edhe një herë vendimit të AK të datës 23.06.2023).Andaj, Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe si e tillë nuk mund të trajtohet nga ana e Panelit shqyrtues.

Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues përkatësisht zyrtarit përgjegjës i prokurimit ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 3 te nenit 61 të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022, lidhur me nenin 108/A paragrafi 11 i LPP-së. Pra, vlerësohet, se zyrtari përgjegjës i prokurimit në rastin konkret nuk ka vepruar sipas dispozitave të lartcekura, pasi që OE Expert Company SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt. 22.06.2023 ndërsa vendimi si përgjigje në kërkesën për rishqyrtim përmban 2/dy data Vendimi i datës 23.06.2023 dhe Vendimi i datës 10.08.2023 për të njëjtë kërkesë për rishqyrtim të OE.

Fakt i konfirmuar edhe nga e-maili i datës 06.09.2023 nga AK – QKUK (*por të cilët pretendojnë se Përgjigja në Kërkesën për rishqyrtim është vonuar për shkak të problemeve teknike të platformës se E-prokurimit, mirëpo AK nuk ka bashkangjitur asnjë prove argumentuese për probleme teknike te pretenduar nga AK*).

Mbi bazën e të lartëcekurave, OSHP konsideron se zyrtari përgjegjes i prokurimit në rastin konkret ka dëshmuar se nuk i plotëson kushtet themelore të kualifikimit sipas nenit 23 të LPP. Kjo për arsye me rastin e menaxhimit të aktivitetit përkatës të prokurimit ka dëshmuar munges të

theksuar të profesionalizmit në fushën e prokurimit publik dhe rrjedhimisht është vendosur sipas pikës III të dispozitivit në këtë vendim.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**
- OE - **Expert Company SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: